




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Procesverbal nga dëgjimi buxhetor për kornizën afatmesme buxhetore KAB 2026-2028

Data: 03.06.2025

Ora: 13:30

Vendi: SHFMU "Fehmi Rama", Likofc

Të pranishëm: Drejtori për Buxhet dhe Financa, z. Ismet Aliu; Drejtori i Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Ambientit, z. Driton Mulaj; Drejtori për Shërbime Publike, z. Alban Shala; Drejtori i Arsimit, z. Kastriot Duraku.

Ismet Aliu: Ju përshëndes të gjithëve që jeni këtu prezent. Mirë që keni ardhur në këto dëgjime vjetore që i kemi për buxhetet. Kryetari ka pasur me ardhë, por ka pasur një agjendë obligative dhe nuk ka mundur me marrë pjesë. Megjithatë, këtu i kam Drejtorin e Urbanizmit, të Arsimit dhe Shërbimeve Publike. Kemi edhe procesmbajtësin që mban evidencë për kërkesat eventuale të juajat. Përmes njoftimit që ka qenë në shpalljen publike, ndoshta e dini rëndësinë e këtij takimi. Ne në këtë kohë fillojmë me buxhetin. I kemi marrë disa kufij prej Ministrisë së Financave për sa mund të jetë buxheti për tre vitet në vijim, nga vijnë mjetet dhe si sigurohen. Një informatë të shkurtër po ua jap materialin që me pa pak a shumë prej nga na vijnë paratë. Popullsia ka rënë edhe në Komunën tonë, sikurse në komuna të tjera. Në vend që me shku buxheti më tepër, ne kemi degraduar. Gjatë viteve të kaluara kemi pasur buxhet për 50,850 banorë, tash kemi marrë për 40,664 banorë. Do të thotë ka rënë kriteri dhe kemi buxhet më pak. Ka zvogëlim të numrit të nxënësve nga 8,110 në 7,101. Të gjitha këto reflektojnë në buxhetin tonë. Ne, përveç shpenzimeve operative që janë të domosdoshme për funksionimin e Komunës dhe për ofrimin e shërbimeve për qytetarë, i kemi analizuar të gjitha me Drejtorët e Drejtorive. Tani jemi këtu për pjesën e projekteve investuese, projektet kapitale për me i dëgjuar propozimet e juaja për tri vitet në vijim, qoftë për vitin e parë, të dytin apo të tretin. Mbrapa letrës e keni një listë të projekteve ku disa prej projekteve janë duke u zhvilluar, disa kanë me qenë projekte të reja. Megjithatë, nuk janë përfundimtare është një draft deri në shtator, derisa ta finalizojmë buxhetin në Kuvend Komunal, shkon në Ministri të Financave, ekziston e drejta e ndryshimit. Ju jeni të lirë me marrë fjalën rreth propozimeve dhe kërkesave të juaja. Edhe para se me marrë fjalën, prezantoheni dhe merret evidenca.

Zaim Mustafa: Përfaqësues i lagjes Mustafa, unë deshta veç pak, e pashë këtë planin dhe kisha kërku që në fshatin Abri e Poshtme të bëhen më shumë investime, sepse jemi i vetmi fshat që kemi mbetur pa ndriçim publik, trotuar dhe disa rrugica të paasfaltuara. Qytetarët janë të zhgënjyer.

Shaban Veseli: Nga fshati Likofc, në lagjen tonë një rrugë mbi 100 metra është vetëm në zhavorr dhe ndriçim publik nuk kemi.

Drejtori i Shkollës SHFMU "Fehmi Rama": Çështjen të cilën do ta ngre ka të bëjë me shkollën, që ka të bëjë me sigurinë e fëmijëve. Në këtë shkollë vijojnë mësimin katër fshatra dhe kemi nevojë për një trotuar dhe vendosjen e disa kamerave brenda shkollës. Kemi raste ku ka familje që i ka 6 fëmijë në shkollë dhe paguajnë kombi-bus për transport. Trotuari do t'ua kishte lehtësuar jetën.

Driton Mulaj: Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket ndriçimit publik, po shpresojmë që deri nga fundi i muajit do të përfundojë pjesa më e madhe e qytetit dhe fshatrave. Mos të marrim shembull fshatrat që kanë përfunduar, jo pse kjo ose ai fshat, sepse kanë me u finalizu të gjitha fshatrat.

Sa i përket kanalizimit, kanalizimi i cili është shtrirë para 6 viteve, ka përfunduar kontrata. Tash e kemi kontraktuar një operator dhe po shpresojmë që deri në gjysmën e muajit gusht do t'i sanojmë këto probleme që i kemi me kanalizim.

Sa i përket trotuarit, ne vetëm sa jemi duke u marrë me subqendrën e Likofcit. Në kuadër të subqendrës, deri tek shkolla është i paraparë trotuari.

Për rrugë kemi premtuar. Po besoj që nga fundi i qershorit planifikojmë të dalim në këtë pjesë, nëse kemi buxhet dhe nuk na i merr përmbaruesi. I kemi të kontraktuar operatorët.

Rizah Kadriu: Përshëndetje për të gjithë. A ka mundësi të na informoni për subqendrën që është duke u ndërtuar në bashkësinë lokale tonë?

Driton Mulaj: Subqendra është duke u ndërtuar. Objektet e vjetra do të rrënohen dhe një pjesë e subqendrës do të gjelbërohet.

Ismet Aliu: Ne do të kemi një buxhet prej rreth 4.160.000,00 € për vitin 2026. Ky është kufiri maksimal. Me këto kapacitete, në kuadër të këtij 4.160.000,00 €, ne jemi ktu për t'i menaxhuar mirë fondet për qytetarët tanë, t'i shikojmë aty ku janë kërkesat më të arsyeshme dhe ku preket mirëqenia e qytetarëve.

Arian Kuliqi: Një pyetje për Drejtorin e Arsimit: a kishte pasur mundësi që ta angazhoni një minibus për transportimin e nxënësve?

Kastriot Duraku: Arian, do ta shqyrtojmë këtë kërkesë dhe do ta shikojmë koston. Brenda mundësive do ta shikojmë realizimin e kësaj kërkesë.

Ismet Aliu: Ju faleminderit për pjesëmarrje, shihemi në dëgjimet tjera buxhetore.

Procesmbajtësi, **Ilmi Kabashi**



REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SKENDERBAUT
DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCO
MUNICIPALITY OF LIKOFÇ
DIREKTORATI PËR BUDZETI FINANSE

